



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 mars 2020
Nr. ref.:RK1527/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

rastin nr. KI57/18

Parashtrues

Hajriz Ferizi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të
Kosovës Ac.nr.5434/2012, të 14 shkurtit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Hajriz Ferizi nga Mitrovica (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës) të cilin në Gjykatë e përfaqëson, Safet Voca avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5434/2012, të 14 shkurtit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] , nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancë administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 prill 2018, parashtruesi i kërkesës nëpërmes shërbimit postar e dërgoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 18 prill 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 25 prill 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës së Apelit të Kosovës.
9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

11. Më 22 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës në vend të gjyqtarit Altay Suroy, të cilit i kishte përfunduar mandati, caktoi gjyqtaren Selvete Gerxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese.
12. Më 11 shkurt 2019 në vend të gjyqtarit Almiro Rodrigues, të cilit i kishte përfunduar mandati, me vendimin për zëvendësimin e Kolegjit shqyrtues Nr.Ksh. KI57/18, kryesuese e Kolegjit shqyrtues u emërua Arta Rama-Hajrizi.
13. Më 5 shkurt 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues, dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Bazuar në shkresat e lëndës , parashtuesi Hajriz Ferizi në qytetin e Mitrovicës në cilësinë e ndërtuesit po ndërtonte, në Rrugën “Ataturku” , në parcelat kadastrale Nr. 408/2, 408/3, 408/4, 408/5, 409/2 dhe 409/3, një ndërtesë afariste – shumë banesore, me etazhitet (B+P+8), për të cilën në emër të rregullimit të tokës ndërtimore kishte obligim që Komunës së Mitrovicës ti paguante tarifën e caktuar.
15. Më 16 maj 2012, Komuna e Mitrovicës –Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm ka nxjerrë Konkluzion, me të cilin kishte konstatuar se parashtuesi i kërkesës nuk e ka kryer pagesën e mbetur të kompensimit në shumën prej 49.078.58 €. në afatin e përcaktuar, në emër të rregullimit të tokës ndërtimore .
16. Më 18 shtator 2012, Komuna e Mitrovicës në cilësinë e kreditorit, ka paraqitur kërkesë për lejimin e përmbarimit kundër parashtuesit të kërkesës mbi bazën e Konkluzionit të 6 majit 2012. Me kërkesë ishte paraqitur edhe dokumentacioni përcjellës me të cilin pretendohet vërtetësia e borxhit të parashtuesit të kërkesës ndaj Komunës.
17. Më 26 tetor 2015, Gjykata Themelore në Mitrovicë nxori Aktvendimin E.nr 560/2012 me të cilin e ka lejuar përmbarimin në këtë çështje juridike.
18. Më 31 gusht 2016, parashtuesi i kërkesës ka ushtruar prapësim kundër Aktvendimit me të cilin lejohej përmbarimi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.
19. Më 2 dhjetor 2016, Gjykata Themelore në Mitrovicë nxori Aktvendimin E.nr.560/2012, me të cilin vendosi që të *”REFUZOHET në tërësi si i pabazuar kundërshtimi i debitorit: Hajriz Ferizi nga Mitrovica, i ushtruar kundër aktvendimit për lejimin e përmbarimit E.nr.560/2012 të dt. 26.10.2015”*.
20. Më 16 dhjetor 2016, kundër Aktvendimit E.nr.560/2012 të 2 dhjetorit 2016 parashtuesi i kërkesës ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
21. Më 12 maj 2017, Gjykata e Apelit në Prishtinë, me Aktvendimin Ac.nr.4872/16 aprovoi si të bazuar ankesën e parashtuesit dhe anuloi Aktvendimin E.nr

560/2102 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dhe çështjen e ktheu në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

22. Më 15 qershor 2017, Gjykata Themelore në Mitrovicë duke vepruar sipas vërejtjeve të dhëna në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, nxori Konkluzionin E.Nr.560/2012 me të cilin urdhëroi kreditorin –Komunën e Mitrovicës që në afatin prej 7 ditësh të sjellë në gjykatë Konkluzionin e 16 majit 2012 (dokumentin për të cilin nga gjykata u kërkua lejimi i ekzekutimit) në original ose në kopje të vërtetuar me vulë të plotfuqishmërisë.
23. Më 25 tetor 2017, Gjykata Themelore në Mitrovicë në procedurën e rivendosjes, nxori Aktvendimin E.nr.560/2012 me të cilin refuzoi në tërësi kundërshtimin e parashtruesit të ushtruar kundër aktvendimit të po kësaj gjykate me të cilin ishte lejuar përmbarimi i Konkluzionit të Komunës së Mitrovicës.
24. Më 26 tetor 2017, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë E.nr.560/2012 parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
25. Më 14 shkurt 2018, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ac.nr.5434/2017 e refuzoi si të pabazuar ankesën e paraqitur dhe vërtetoi në tërësi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.
26. Më 15 mars 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit të Kosovës.
27. Më 30 mars 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit me njoftimin KMLC nr.43/2018 njoftoi parashtruesin se nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për të ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se gjykatat e rregullta, i kanë shkelur të drejtën e barazisë para ligjit (neni 24) dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31) të Kushtetutës lidhur me të drejtën për një proces të rregullt (neni 6 i KEDNJ).
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, gjykatat e rregullta nuk i kanë trajtuar pretendimet e tij kryesore lidhur me faktin se Konkluzioni i Komunës, mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi nga Gjykata Themelore në Mitrovicë nuk ishte dokument i vlefshëm ligjor për tu cilësuar si titull ekzekutiv, sikurse edhe faktin se detyrimi monetar i cili i kërkohet nga Komuna tashmë ishte parashkruar.
30. Parashtruesi i kërkesës më tej ka potencuar se Gjykata Themelore në Mitrovicë, me rastin e rivendosjes së rastit në procedurë përmbarimore nuk i ka marrë fare parasysh të gjeturat e Gjykatës së Apelit dhe se, gjithmonë sipas parashtruesit, të dy Aktvendimet e Gjykatës Themelore në dy rastet janë pothuajse identike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka theksuar se ai do të duhej të përfitonte nga Ligji për faljet dhe se faktikisht sipas tij borxhi i kërkuar do të duhej të mos llogaritej fare.

31. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata deklarin e kërkesës si të pranueshme, përcaktimin e shkeljeve të pretenduara të dispozitave të Kushtetutës dhe të KEDNJ dhe anulimin e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.5434/2017 të 14 shkurtit 2018.

Dispozitat relevante Kushtetuese dhe ligjore të aplikueshme në rastin konkret

32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka pretenduar në mënyrë specifike se me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.5434/2017 të 14 shkurtit 2018 atij i është shkelur e drejta e barazisë para ligjit dhe e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të përcaktuara me nenet 24 të Kushtetutës , respektivisht 14 të KEDNJ, dhe 31 të Kushtetutës dhe e drejta për një proces të rregullt e përcaktuar me nenin 6 të KEDNJ që kanë përmbajtjen si në vijim:

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.”*

Neni 14 [Ndalimi i diskriminimit]

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet politike ose çdo opinion tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtarë, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.”

Neni 31 [E drejta në gjykim të drejtë e të paanshëm]

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

Neni 6 i KEDNJ-së [E drejta për një proces të rregullt]

1. *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e Gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në*

proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

[.....]

Ligji për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139)

Neni 4 Fillimi i procedurës

- 1. Procedura e përmbarimit fillohet me propozimin e kreditorit.*
- 2. Procedura e përmbarimit fillohet nga Gjykata sipas detyrës zyrtare kur me Ligj parashihet një gjë e tillë.*

Neni 36 Vërtetimi për përmbarueshmërinë

- 1. Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri.*

Neni 38 Propozimi për përmbarim

- 1. Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.*

Neni 67 Mjetet e rregullta juridike

- 1. Në procedurën përmbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë:*

1.1. Prapësimi dhe

1.2. Ankesa.

Neni 73 Vendosja sipas prapësimit

- 2. Vendimi për prapësim nxirret nga një gjyqtar i vetëm.*

Neni 77
Ankesa kundër vendimit lidhur me prapësimin

1. Palët kanë të drejtë ankesë kundër vendimit mbi prapësimin.

2. Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të Punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 7 i Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

35. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

36. Së fundi, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

37. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit i përmbush kriteret e nenit 113.7 sa i përket palës së autorizuar dhe shterjes së mjeteve juridike; që kërkesa është parashtruar brenda afateve të nenit 49 të Ligjit, siç janë specifikuar dispozitat juridike që pretendohet që janë shkelur, andaj, Gjykata në vijim duhet të konstatojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e parapara me rregullin 39 të Rregullores së punës.

38. Gjykata rikujton se në bazë të nenit 53 të Kushtetutës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” [GJEDNJ], andaj gjatë shqyrtimit të rasteve para saj, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

39. Gjykata, vëren se çështja juridike në të cilën parashtruesi i kërkesës ishte palë ka filluar me Konkluzionin e Komunës së Mitrovicës të 16 majit 2012, e në bazë të së cilit parashtruesi i kërkesës ngarkohej që Komunës t’i paguajë një shumë të

hollash në emër të borxhit të papaguar për rregullimin e tokës ndërtimore në të cilën parashtruesi i kërkesës kishte ndërtuar një godinë shumëkatëshe.

40. Parashtruesi i kërkesës kishte ngritur pretendime se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtën e barazisë para ligjit si dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kur kanë vendosë në çështjen juridike në të cilën parashtruesi i kërkesës ishte palë.

Sa i përket nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ

41. Gjykata, fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës pretendimin për shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e arsyeton se gjykatat nuk i kishin trajtuar pretendimet e paraqitura prej tij.
42. Në këtë rast, Gjykata thekson se mos adresimi apo mos trajtimi eventual i pretendimeve thelbësore të parashtruesve të kërkesave janë elemente përbërëse të së drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor që janë pjesë e garancive të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ dhe në këtë kuadër edhe trajtohen nga Gjykata (shih, ndër të tjera, Aktgjykimet e Gjykatës për rastet: KI135/14 të 8 shkurtit 2016; KI18/16 të 13 korrikut 2016; KI22/16 të 2 majit 2017; KI24/17 të 19 korrikut 2019 KI35/18 të 6 janarit 2020, Aktvendimin në rastin KI143/16 të 8 qershorit 2018).
43. Gjykata në vazhdimësi ka potencuar se gjatë shqyrtimit të kërkesës me pretendimin për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm vlerëson nëse procesi gjyqësor, në tërësinë e tij, ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih, në mes tjerash *mutatis mutandis*, *Edwards kundër Mbretërisë së bashkuar*, 16. dhjetor 1992 shih, gjithashtu, Aktvendimin për Papranueshmëri i Gjykatës në rastin KI85/16 të 13 shtatorit 2016, të parashtruesit *Esat Haxhiu*, par. 25)
44. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendimet e ngritura në Gjykatë, i kishte ngritur edhe para gjykatave të rregullta sikurse ishin çështja e Konkluzionit të Komunës si titull ekzekutiv dhe si akt përmbarimor, si dhe çështja e parashkrimit të kërkesës së Komunës lidhur me detyrimin monetar që i kërkohej parashtruesit. Lidhur me këtë, Gjykata konstaton se çështja juridike e parashtruesit kishte qenë objekt trajtimi dy herë në gjykatën e shkallës së parë dhe dy herë në Gjykatën e Apelit.
45. Gjykata konstaton se Gjykata Themelore në Mitrovicë me Aktvendimin E.nr.560/2012 të 25 tetorit 2017 (në procedurën e rivendosjes) vendosi që të refuzojë prapësimin (kundërshtimin) e parashtruesit të kërkesës duke arsyetuar se kreditori sipas kërkesës së Gjykatës Themelore ka sjellë dokumentin origjinal përmbarimor me vulë të plotfuqishmërisë. Në këtë mënyrë Gjykata Themelore i ka dhënë përgjigje pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur për pranimin e Konkluzionit të Komunës si dokument të vlefshëm përmbarimor, andaj, nuk mund të qëndrojë pretendimi se nuk është trajtuar nga gjykata çështja e Konkluzionit të Komunës si akt përmbarimor.
46. Gjykata vëren se, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me natyrën juridike të dokumentit përmbarimor, Gjykata e Apelit në Aktvendimin

AC.nr 5434 /2017 më të cilin përfundimisht kishte vendosur meritat e kësaj çështje juridike, ka arsyetuar: *“ky pretendim nuk qëndron ngase gjykata e cakton përmbarimin vetëm në bazë të titullit përmbarues sipas nenit 23 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore e në rastin konkret titull përmbarues është konkluzioni i dhënë në procedurë administrative. Dhe më tej “dispozita e nenit 23 par. 2 LPP-se ku decidivisht është përcaktuar vendim i organit administrativ sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ, apo personi juridik i ngarkuar me punë publike”.*

47. Lidhur me si më sipër, Gjykata e Apelit në arsyetimin e aktvendimit kishte theksuar se *“në rastin konkret konkluzioni është dhënë në procedurë administrative nga organi me autorizime publike”.*
48. Gjykata, po ashtu, vëren se Gjykata e Apelit e ka shqyrtuar edhe pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me parashkrimin e kërkesës dhe ka konstatuar: *“Sa i përket pretendimeve ankimore se ka arritur parashkrimi në këtë çështje përmbarimore ky pretendim është i pa bazuar sepse bazuar në shkresat e lëndës konkluzioni është nxjerrë me datë 16.05.2012 dhe është lejuar në gjykatë me datë 18.09.2012, sipas nenit 144 par 3 te Ligji Nr. U.5/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Akti administrativ nuk mund te ekzekutohet nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga koha kur akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm dhe nuk është marrë asnjë veprim ekzekutimi apo kanë kaluar 3 (tre) vite nga veprimi i fundit për ekzekutim bazuar në këto fakte kreditori propozimin e ka paraqitur brenda afatit të paraparë ligjor”.*
49. Si përfundim, Gjykata konstaton se edhe Gjykata Themelore edhe Gjykata e Apelit i kanë trajtuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe duke aplikuar ligjin në fuqi kanë dhënë përgjigje në ato pretendime. Gjykata më tej gjen se vendimet gjyqësore në substancën e tyre nuk janë arbitrare sikurse që edhe procedurat e zhvilluara gjyqësore në tërësinë e tyre nuk janë tregues të ndonjë shkeljeje kushtetuese.
50. Gjykata me tej rikujton se bazuar në parimin e subsidiaritetit, ajo nuk mund të marrë rolin e gjykatës së shkallës së katërt dhe nuk gjykon lidhur me rezultatin përfundimtar të vendimeve gjyqësore (shih *Fc Mretebi kundër Gjeorgisë*, par. 31, Aktgjykimi i GJENDJ-së, i 31 korrikut 2007, shih, gjithashtu, Aktvendimin e Gjykatës për rastin KI 123/17 të parashtruesit *Hasim Eljami*, të 11 janarit 2018)

Sa i përket nenit 24 të Kushtetutës lidhur me nenin 14 të KEDNJ

51. Gjykata vëren se parashtruesi me asnjë provë nuk e dëshmoi papabarazinë e pretenduar para ligjit. Ai nuk arriti të dëshmojë se nuk iu sigurua mbrojtja e barabartë ligjore ose që në cilën do bazë mund të jetë diskriminuar e që janë kërkesat themelore të nenit 24 të Kushtetutës. Për më tepër, këtë normë kushtetuese parashtruesi i kërkesës vetëm e ka përmendur në kërkesë por nuk ka dhënë asnjë arsyetim se në cilat kushte dhe rrethana ajo eventualisht është cenuar.

52. Gjkata rithekson se me qëllim të interpretimit të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së, një trajtim ndryshe është i pabarabartë dhe arbitrarisht: 1) nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, më fjalë të tjera, në qoftë se nuk ndjek një qëllim legjitim, ose 2) kur nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti (përkatesisht përpjesëtueshmërie) ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet (shih, *mutatis mutandis*, *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kunder Mbreterisë së Bashkuar*, kërkesat nr. 9214/80; 9473/81 dhe 9474/81, 24 prill 1985, paragrafi 72)".
53. Bazuar në rrethanat e rastit konkret, Gjykata nuk gjen se vendimet e gjykatave janë tregues i shkeljes së pretenduar të nenit 24 të Kushtetutës. Me këtë rast pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të barazisë para ligjit janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
54. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm e ka paraqitur si fakt njoftimin e Kryeprokurorit të Shtetit me të cilin është njoftuar se Zyra e Kryeprokurorit dhe po e njëjta, nuk ka gjetur prova të mjaftueshme për të ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në këtë çështje juridike por se specifikisht parashtruesi i kërkesës nuk e ka kontestuar këtë akt juridik.
55. Gjykata rrjedhimisht konkludon se kërkesa në baza kushtetuese nuk është e arsyetuar dhe se parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e ka dëshmuar e as mbështetur me prova pretendimin për shkelje të një të drejte kushtetuese; andaj, në përputhje me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, më 5 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Selvete Gerxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Zeta Rama-Hajrizi